VENDIM
Nr. 341, datë 22.5.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E EMERGJENCAVE DHE SHPËTIMIN, SI DHE PROCEDURAVE TË HARTIMIT, PËRMBAJTJES E MIRATIMIT TË PLANIT TË EMERGJENCËS, TË DETYRUESHME PËR SUBJEKTET QË KRYEJNË PUNIME NËNTOKËSORE DHE SUBJEKTET E TJERA QË KRYEJNË PUNIME NË NËNTOKË, NË MINIERA APO NË PUNIMET NËNTOKËSORE TË VEPRAVE HIDROENERGJETIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 135/2016, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e emergjencave dhe shpëtimin, si dhe procedurave të hartimit, përmbajtjes e miratimit të planit të emergjencës, të detyrueshme për subjektet që kryejnë punime nëntokësore dhe subjektet e tjera që kryejnë punime në nëntokë, në miniera apo në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E EMERGJENCAVE DHE SHPËTIMIN, SI DHE TË PROCEDURAVE TË HARTIMIT, PËRMBAJTJES E MIRATIMIT TË PLANIT TË EMERGJENCËS, TË DETYRUESHME PËR SUBJEKTET QË KRYEJNË PUNIME NËNTOKËSORE DHE SUBJEKTET E TJERA QË KRYEJNË PUNIME NË NËNTOKË, NË MINIERA APO NË PUNIMET NËNTOKËSORE TË VEPRAVE HIDROENERGJETIKE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

a) të garantojë sigurinë e shëndetit të punonjësve gjatë zhvillimit të punimeve nëntokësore në miniera dhe veprat hidroenergjetike;

b) të shërbejë si dokument i rëndësishëm për subjektet për të marrë masat dhe përcaktuar veprimet e nevojshme për parashikimin e parandalimin e emergjencave, shpëtimin e punonjësve dhe likuidimin e avarisë në lindje dhe gjatë zhvillimit;

c) të garantojë mjete efikase dhe kompetente të kontrollit dhe veprimeve shtetërore në zhvillimin e punimeve nëntokësore, në miniera dhe në veprat hidroenergjetike.

2. Objekti

2.1 Kjo rregullore është e detyrueshme të zbatohet nga:

a) të gjitha subjektet shtetërore e private, vendase dhe të huaja, që kryejnë veprimtari në zhvillimin e punimeve nëntokësore në miniera dhe në veprat hidroenergjetike;

b) të gjitha subjektet që studiojnë, projektojnë e miratojnë programe zhvillimi për punime nëntokësore, në miniera dhe në veprat hidroenergjetike;

c) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), si organ kontrolli shtetëror dhe qendër e vetme kombëtare për emergjenca dhe shpëtim, nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave dhe Shpëtimit.

2.2 Kjo rregullore rekomandohet të zbatohet edhe nga subjekte që zhvillojnë punime nëntokësore në veprat e inxhinierisë civile, si për qëllime transporti, hidroteknike, komunale apo për qëllime të tjera të veçanta.

3. Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. "Aktivitet minerar fqinj", zhvillimi i punimeve nëntokësore nga subjekte të ndryshme që janë ngjitur ose afër njëra-tjetrës.
2. "Aktivitet nëntokësor", tërësia e punimeve dhe e proceseve të punës që kryhen në çdo vend nën sipërfaqen natyrore të tokës.
3. "Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM)", institucioni shtetëror i kontrollit, ndërhyrjes në emergjenca e shpëtim dhe trajnimit e testimit të specialistëve për emergjencë e shpëtim të subjekteve.
4. "Avari minerare", prishje e regjimit normal të punës në vende të veçanta ose tërësinë e zhvillimit të punimeve, dëmtime të teknologjisë dhe rrezikim të jetës së njerëzve.
5. "Baza e nisjes", vendi i zgjedhur nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit për zbatimin e emergjencës nga ku niset skuadra për veprim.
6. "Drejtues teknik", person i emëruar nga zotëruesi i lejes minerare nën autoritetin e të cilit zhvillohen e drejtohen teknikisht punimet nëntokësore dhe që përgatit, organizon e drejton shërbimin e emergjencës dhe shpëtimit në objekt.
7. "Dhoma e shpëtimit", një mjedis emergjence në nëntokë.
8. "Emergjencë", një situatë e krijuar gjatë aktivitetit nëntokësor nga faktorë të parashikueshëm ose të paparashikueshëm, që ka sjellë ose mund të sjellë avari dhe që kërkon përgatitje për marrje masash të menjëhershme për largimin dhe shpëtimin e njerëzve (likuidimin e avarisë dhe normalizimin e gjendjes).
9. "Marrëveshje", një kontratë bashkëpunimi e lidhur ndërmjet dy personave përfaqësues të subjekteve të ndryshme, për realizimin e detyrave të përbashkëta për emergjencë dhe shpëtim, të lejuara në këtë rregullore.
10. "Përgjegjës për emergjencë dhe shpëtim", drejtuesi teknik i objektit ku zhvillohen punimet nëntokësore.
11. "Plani i emergjencës dhe shpëtimit", një dokument tekniko-organizativ për sigurinë, i përgatitur, shkruar e përpunuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
12. "Skuadër shpëtimi", njësi organizimi e punonjësve të veçantë për të kryer veprimtari shpëtuese, e përbërë nga 5 deri 7 veta.
13. "Shpëtues i punësuar", person i përgatitur dhe i aftë për të kryer, në çdo kohë që kërkohet, veprimtari shpëtuese dhe që nuk kryen veprimtari të tjera gjatë kohës së punës.
14. "Shpëtues vullnetar", personi i përgatitur dhe i aftë për të kryer në çdo kohë që kërkohet veprimtari shpëtuese dhe që kryen veprimtari të tjera gjatë kohës së punës.
15. "Veprimtari shpëtuese", organizimi, drejtimi dhe kryerja e veprimeve për shpëtimin e njerëzve, sqarimin e situatës, likuidimin e avarisë dhe vendosjes së gjendjes normale.
16. "Zotërues i lejes minerare", personi juridik, të cilit i është dhënë një leje minerare në zbatim të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

II. PLANI I EMERGJENCËS DHE SHPËTIMIT (PESH)

II.1 Dispozita të përgjithshme

2.1.1 Çdo subjekt që zhvillon punime minerare nëntokësore në miniera dhe vepra hidroenergjetike ka për detyrë që para fillimit të punimeve të përgatisë planin e emergjencës dhe të shpëtimit.

2.1.2 Në planin e emergjencës dhe të shpëtimit shqyrtohen, vlerësohen dhe parashikohen hollësisht të gjitha rastet e mundshme të lindjes së emergjencave dhe përcaktohen për secilën prej tyre masat e efektshme për largimin dhe shpëtimin e punonjësve, likuidimin e pasojave dhe normalizimin e gjendjes.

2.1.3 Plani i emergjencës dhe shpëtimit përgatitet nga drejtuesi teknik i subjektit, për çdo objekt ku kryhet aktivitet, dhe miratohet nga komisioni i ngritur në AKSEM.

2.1.4 Plani i emergjencës dhe shpëtimit përgatitet për çdo vit ushtrimor të aktivitetit sipas aktit të miratimit të programit të zhvillimit të punimeve dhe një kopje e tij dërgohet pranë Drejtorisë së Emergjencës dhe Shpëtimit në AKSEM, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të planit vjetor të zhvillimit të punimeve nga AKBN-ja. Miratimi i PESH-së nga komisioni i ngritur në AKSEM bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit.

2.1.5 Subjektet që fillojnë veprimtari për zhvillimin e punimeve nëntokësore për herë të parë, e dorëzojnë në AKSEM planin e emergjencës dhe shpëtimit, 30 (tridhjetë) ditë para fillimit të aktivitetit.

2.1.6 Plani i emergjencës dhe shpëtimit duhet të përgatitet në shkallë objekti në përfshirje të çdo fronti e vendi pune, zone e sektori, dhe çdo 6 muaj ky plan duhet të azhurnohet, ku të pasqyrohen ndryshimet eventuale në gjendjen e punimeve e të kushteve tekniko-minerare e gjeologjike.

2.1.7 Me planin e emergjencës dhe të shpëtimit duhet të njihen mirë punonjësit në bazë fronti e vendi pune, brigade, turni, personeli teknik dhe çdo skuadër e emergjencës dhe shpëtimit.

2.1.8 Njohja e këtij plani nga çdo punonjës bëhet nga drejtuesi teknik, i dokumentuar me shkrim çdo 6 muaj dhe sa herë pëson ndryshime.

2.1.9 Subjektet që kryejnë aktivitet për zhvillimin e punimeve nëntokësore dhe që janë ngjitur apo afër njëri-tjetrit dhe që kanë nëntokë më pak se 25 punëtorë në turn me marrëveshje dhe miratim të AKSEM-së mund të përgatisin një plan të përbashkët për emergjencë dhe shpëtim.

II.2 Plani i emergjencës dhe shpëtimit (PESH) duhet të përmbajë:

a) përshkrimin e plotë të emërtimit të subjektit që kryen veprimtari për zhvillimin e punimeve nëntokësore dhe objektin për të cilin përgatitet plani i emergjencës dhe shpëtimit;

b) numrin e lejes minerare apo koncesionare, zotëruesin e së drejtës për aktivitet, vendndodhjen, rrethin, bashkinë, zonën, vendbanimin, telefonin;

c) autoritetin teknik që ka përgatitur PESH-në;

ç) adresën e plotë të drejtuesit teknik, vendbanimin, vendqëndrimin, numrin e telefonit;

d) autorizimin e zotëruesit të lejes minerare apo koncesionare për personin që do të drejtojë e organizojë punën në rast emergjence dhe likuidim avarie kur mungon drejtuesi teknik;

dh) përshkrimin e plotë të emergjencave të mundshme si:

i. emergjencë nga eksplozionet nga gazet dhe pluhurat në punimet nëntokësore;

ii. emergjencë nga zjarret nëntokësore e ato sipërfaqësore, kur produktet e djegies mund të futen nëntokë;

iii. emergjencë nga çlirimet e befasishme dhe të vrullshme të gazeve, ujërave, llurbave etj.;

iv. emergjencë si rezultat i bllokimit të punonjësve nga shembjet e punimeve nëntokësore;

v. emergjencë nga pakësimi i përmbajtjes së oksigjenit në atmosferën e nëntokës;

vi. emergjencë energomekanike;

vii. emergjencë për ngjarje aksidentale etj.;

e) përshkrimin e plotë të veprimtarisë për subjektet fqinje ose ngjitur;

ë) numrin e subjekteve që zhvillojnë punime nëntokësore në të njëjtin trup, panel, zonë;

f) punimet minerare lidhëse nëntokësore që shërbejnë për subjekte të ndryshme;

g) kolonat (taniket) ndarëse e mbrojtëse të punimeve nëntokësore për subjekte të ndryshme;

gj) përshkrimin e vlerësimit të rreziqeve të mundshme, si:

i. pasojat për shëndetin e punonjësve që shkaktohen nga subjekti që kryen punime nëntokësore, që ndikohen nga emergjenca që lind ose mund të ndodhë gjatë zhvillimit të punimeve;

ii. faktorët që mund të çojnë në lindjen dhe shkaktimin e emergjencave të mundshme gjatë zhvillimit të punimeve nëntokësore.

II.3 Përshkrimi i plotë i organizimit të punës dhe zhvillimit të punimeve nëntokësore përmban:

a) vendet e punës në zhvillimin e punimeve nëntokësore kryesore (kapitale), numrin e punëtorëve për çdo front;

b) vendet e punës në zhvillimin e punimeve nëntokësore në kërkim, zbulim, përgatitje, numrin e punonjësve për çdo front;

c) vendet e punës në zhvillimin e punimeve të shfrytëzimit, numrin e punonjësve në çdo front;

ç) përcaktimin e rrugëdaljeve të dyta (rezervë) në bazë vendi, pune, niveli, llave, blloku etj.;

d) saktësimin e fronteve pa rrugëdalje rezervë, kohën dhe arsyet e mungesës për parandalimin e rreziqeve.

2.4 Përcaktimi dhe përshkrimi i plotë i skemës së organizimit dhe drejtimit të punimeve për përballimin e emergjencës, shpëtimin e njerëzve dhe likuidimin e avarisë, përmban:

a) punën dhe detyrimin e zotëruesit të lejes minerare apo koncesionare, masat për njoftim, mënyrën e njoftimit dhe angazhimin e tij;

b) detyrat dhe punën e përgjegjësit të emergjencës dhe shpëtimit, zëvendësit të tij, përgjegjësitë për zbatimin e ndërhyrjes operacionale;

c) saktësimin e vendeve ku mund të ndodhin emergjencat, mënyrat dhe rrugët nga ku do të largohen punonjësit;

ç) thirrjen e forcave shtesë të vetë subjektit apo subjekteve të tjera në vendin e ndodhjes së emergjencës;

d) masat e menjëhershme për shpëtimin dhe ardhjen në ndihmë punonjësve të dëmtuar apo të lënduar nga emergjenca e ndodhur;

dh) masat për komunikim dhe përdorimin e menjëhershëm të pajisjeve e mjeteve vetëshpëtuese individuale;

e) mënyrën e organizimit dhe të lajmërimit të skuadrës së shpëtimit të vetë subjektit, të skuadrave të shpëtimit të subjekteve fqinje, të skuadrës së shpëtimit të subjektit që është kontraktuar shërbimi i shpëtimit dhe lajmërimi i skuadrave të shpëtimit në AKSEM;

ë) përshkrimin dhe përcaktimin e saktë të të gjitha operacioneve që duhet të realizohen për çdo emergjencë e shpëtim të parashikuar sipas tipit e llojit;

f) përcaktimin e sistemit të lajmërimit me struktura të tjera të emergjencës shtetërore në shkallë rrethi, qarku e republike;

g) detajimin e hollësishëm të bazës materiale rezervë për çdo rast emergjence si lëndë drusore, tubo të ndryshme, pajisje, makineri, mjete etj.

1.5 Skuadra e shpëtimit duhet të organizohet dhe të funksionojë, si më poshtë vijon:

a) përbërja, gjendja dhe gatishmëria e skuadrës së shpëtimit;

b) ndërtimi dhe funksionimi i vendit të skuadrës së shpëtimit;

c) kompletimi dhe gjendja teknike e funksionale e mjeteve dhe pajisjeve të shpëtimit për skuadrën e shpëtimit;

ç) kompletimi i subjektit me ambiente të gatishmërisë e pajisje për dhënien e ndihmës së parë mjekësore;

d) organizimi i punëve për shpëtim me skuadrat e subjekteve fqinje dhe skuadrat e shpëtimit të subjekteve të kontraktuara për veprimtari emergjence dhe shpëtimi;

dh) marrëveshje kontraktore për shërbim emergjence dhe shpëtimi me skuadra shpëtimi të subjekteve që i kanë të miratuara, organizuara e funksionale skuadrat e shpëtimit;

e) caktimi dhe funksionimi i bazës së nisjes së skuadrës së shpëtimit në nëntokë dhe mënyrat e komunikimit.

1.6 Planimetritë e punës që shoqërojnë PESH-në

2.6.1 Planimetria e plotë e objektit ku zhvillohen punimet minerare nëntokësore, ku përfshihet i gjithë rrjeti i zhvillimit të punimeve, objektet nëntokësore dhe sipërfaqësore. Në këtë planimetri duhet të paraqiten, si më poshtë vijon:

a) gjendja aktuale dhe zhvillimi i punimeve sipas planit vjetor të miratuar në AKBN;

b) rrugëdaljet e dyta (rezervë) për minierën, për çdo nivel, llave, front e vende pune, si dhe kolonat (taniket) mbrojtëse e kufizuese brenda punimeve nëntokësore të objektit dhe të objektit të subjekteve fqinje;

c) përcaktimi i qartë i llojit dhe vendit ku mund të lindë një situatë emergjence në punimet nëntokësore;

ç) skema e drejtimit të rrymave të ajrit për ajrimin e çdo fronti, vendosja e ventilatorëve, dyerve dhe pritave të ajrimit;

d) skema e reversionit (ndryshimit të drejtimit të rrymave të ajrit);

dh) skema e rrjetit energomekanik;

e) skema e shpërndarjes së tubacioneve të ajrit të komprimuar, të heqjes së ujërave, vendndodhjen e depos së lëndëve plasëse, vendndodhjen e stacioneve qendrore e provizore të pompimit;

ë) skema e rrjetit të telefonisë, vendndodhja e kompleteve dhe pajisjeve vetëshpëtuese nëntokë, vendndodhja e pajisjeve të MKZ-së.

2.6.2 Planimetria e plotë plotësohet e punohet konform rregullave teknike inxhinierike nga personeli teknik i subjektit, sipas sektorëve që mbulojnë dhe miratohet nga përgjegjësi për emergjenca e shpëtim.

III. DETYRAT E PERSONELIT TË EMERGJENCËS DHE SHPËTIMIT

3.1 Detyrat e zotëruesit të lejes minerare ose koncesionare janë, si më poshtë vijon:

3.1.1 Të sigurojë numrin e nevojshëm të punonjësve për përballimin e emergjencës, shërbimit me mjete e pajisje mjekësore në ndihmë të punonjësve të lënduar dhe zbaton urdhrat e institucioneve shtetërore.

3.1.2 Të ndjekë në mënyrë periodike situatën dhe në vlerësim të situatës, të mundësive e burimeve të veta, njofton pa vonesë AKSEM-në.

3.1.3 Të sigurojë mbështetjen e pandërprerë me furnizim material teknik dhe sipas nevojave që kërkohen, organizon dërgimin e tyre në vendin e ndodhjes së emergjencës.

3.1.4 Të organizojë shërbimin e nevojshëm në vende të caktuara dhe mban lidhje të vazhdueshme për ndihmë, komunikim e sqarim me organet e pushtetit vendor e qendror.

3.1.5 Të informojë institucionet dhe organet shtetërore mbi karakterin e emergjencës, zhvillimin e veprimtarisë shpëtuese dhe saktëson ndihmën që kërkon.

3.1.6 Të drejtojë dhe organizojë punën e transportit në sipërfaqe.

3.1.7 Të emërojë autoritetin teknik për emergjencë dhe shpëtim, në mungesë të drejtuesit teknik të subjektit.

3.1.8 Të koordinojë punën për sigurimin e ndihmës për shpëtim dhe likuidim të avarisë me subjektet fqinje dhe aktorë të tjerë rajonalë për emergjencë dhe shpëtim.

3.2 Detyrat e përgjegjësit për emergjencën dhe shpëtimin janë, si më poshtë vijon:

3.2.1 Drejton të gjithë aktivitetin për emergjencën dhe shpëtimin në miniera dhe punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike.

3.2.2 Thërret dhe urdhëron hyrjen e skuadrës së shpëtimit dhe të punonjësve të tjerë në veprim.

3.2.3 Përcakton dhe sqaron vendin në punimet nëntokësore ku ka ndodhur emergjenca dhe numrin e punonjësve që rrezikohen nga kjo emergjencë.

3.2.4 Krijon shtabin e punës për ndërhyrje në emergjencë dhe shpëtim dhe jep urdhra e udhëzime me shkrim.

3.2.5 Regjistron në librin e emergjencës të gjitha urdhrat dhe udhëzimet që jep gjatë fazës së lindjes, zhvillimit të emergjencës dhe deri në likuidimin e avarisë.

3.2.6 Merr dhe jep informacion për zhvillimin e punëve, gjendjen e punonjësve, veprimet e skuadrës së shpëtimit dhe të punonjësve të tjerë të angazhuar në përballimin e situatës.

3.2.7 Verifikon saktësinë e përpunimit të planit të emergjencës dhe të shpëtimit, ndërhyn dhe përcakton zgjidhje të reja kur lindin si nevojë e karakterit specifik të emergjencës apo të kushteve teknike e gjeologo-minerare.

3.2.8 Organizon dhe drejton grafikun e shërbimit të shpëtimit për të gjithë kohën e pandërprerë që kërkohet për likuidimin e avarisë dhe ngarkon me detyra personelin teknik të subjektit.

3.2.9 Organizon bashkërendimin ndërmjet skuadrave të shpëtimit ardhura në ndihmë nga subjekte të tjera, AKSEM-ja me veprimet e skuadrës shpëtuese të subjektit kur avaria është e rëndë dhe e gjatë.

3.2.10 Shpall gjendjen e emergjencës në veprimtarinë e subjektit dhe fut në zbatim të plotë PESH-në.

3.2.11 Evidenton të gjithë aktivitetin e kryer nga skuadrat e emergjencës e shpëtimit.

3.3 Detyrat e përgjegjësit të skuadrës së emergjencës dhe shpëtimit janë, si më poshtë:

3.3.1 Organizon dhe drejton punën e skuadrës së shpëtimit dhe të punonjësve të tjerë që janë caktuar të ndihmojnë në emergjencë, shpëtimin e punonjësve dhe likuidimin e avarisë.

3.3.2 Merr urdhra dhe udhëzime me shkrim nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit, i zbaton dhe raporton për kryerjen e tyre.

3.3.3 Jep ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit deri në sigurimin e ardhjes së shërbimit shëndetësor.

3.3.4 Aktivizon në punë shpëtues, punonjës me përvojë dhe personelin teknik të subjektit të caktuar pranë tij nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit.

3.3.5 Bën ndryshimin në zbatimin e masave të marra për likuidimin e avarisë, kur kjo diktohet nga kushte konkrete, me miratim të përgjegjësit të emergjencës.

3.3.6 Mban skuadrën të bashkuar dhe përgjigjet për sigurimin e jetës së tyre gjatë veprimeve shpëtuese dhe likuidimin e avarive.

3.4. Detyrat e përgjegjësit të ajrimit:

3.4.1 Paraqitet menjëherë në detyrë dhe zbaton urdhrat që i jep përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit. Në zbatim të urdhrave të tij merr masa për manovrimin e ventilatorëve, dyerve e pajisjeve të ajrimit.

3.4.2 Kontrollon punën dhe gjendjen e ventilatorëve dhe informon për këtë përgjegjësin e emergjencës dhe shpëtimit, organizon shërbim të posaçëm pranë ventilatorit stacionar.

3.4.3 Njofton personelin teknik të minierës fqinje në ato raste kur punimet ku ka ndodhur emergjenca kanë lidhje me punimet nëntokësore të këtij subjekti.

3.4.4 Kryen punimet që kanë të bëjnë me ajrimin e punimeve minerare nëntokësore, në zbatim të planit të emergjencës dhe të shpëtimit, në bazë të urdhrit të përgjegjësit të emergjencës.

3.4.5 Siguron dhe mban në regjim pune të pandërprerë punonjësit e shërbimit të ajrimit.

3.5. Detyrat e përgjegjësit energomekanik janë, si më poshtë vijon:

3.5.1 Paraqitet menjëherë në detyrë dhe zbaton urdhrat që jep përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit, organizon dhe drejton specialistët energomekanikë për nevojat e emergjencës dhe shpëtimit.

3.5.2 Realizon takim-stakimet e energjisë elektrike, dhënien e ajrit të komprimuar dhe takim-stakimin e stacionit të pompave.

3.5.3 Siguron në mënyrë të pandërprerë punën e makinerive, pajisjeve, të impjanteve të ndryshme energomekanike, bën ndryshime të kërkuara në projektin energomekanik dhe merr masa për sigurimin e makineri-pajisjeve të reja kur ato kërkohen.

3.5.4 Siguron dhe merr masa për furnizim të pandërprerë të subjektit me energji elektrike, siguron punën pa ndërprerje të ndriçimit dhe linjave telefonike.

3.5.5 Informon për punën e kryer, zbatimin e detyrave, problemet që dalin, përgjegjësin e emergjencës dhe shpëtimit.

3.6 Detyrat e personelit tjetër administrativo-teknik janë, si më poshtë vijon:

a) paraqiten menjëherë në detyrë pranë vendeve të tyre të punës dhe marrin detyra e udhëzime vetëm nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit;

b) organizojnë dhe drejtojnë punën për sektorët që mbulojnë në funksion të kërkesave të situatës së emergjencës dhe shpëtimit.

3.7. Detyrat e përgjegjësit të sektorit, ndërresës, brigadës janë, si më poshtë vijon:

3.7.1 Menjëherë sapo konstatojnë rast emergjence apo shenja të saj marrin masa në vend për likuidimin ose kufizimin e saj dhe njoftojnë menjëherë përgjegjësin e emergjencës dhe shpëtimit.

3.7.2 Përcaktojnë saktësisht vendin ku ka lindur ose mund të lindë rasti i emergjencës, ndikimin e saj te punonjësit dhe marrin masa për largimin apo sigurimin e jetës së tyre.

3.7.3 Përcakton dhe informon për shkaqet, madhësinë dhe karakterin e rastit emergjent që ka ndodhur apo ka shenja të ndodhë.

3.7.4 Merr pjesë aktive në veprimet e përcaktuara nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit, për shpëtimin e jetës së punonjësve dhe likuidimin e avarisë.

IV. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT PËR EMERGJENCA DHE SHPËTIM

4.1 Organizimi dhe kontrolli i shërbimit për emergjenca dhe shpëtim

4.1.1 Organizimi i shërbimit për emergjenca dhe shpëtim në zhvillimin e punimeve nëntokësore në shkallë vendi në miniera dhe veprat energjetike realizohet si drejtori e veçantë në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.

4.1.2 Çdo subjekt që zhvillon punime nëntokësore, në të cilat është vërtetuar prania e gazit metan dhe e gazeve të tjera eksploduese, qoftë edhe në një vend pune të veçantë ose ekziston mundësia e shfaqjes së këtyre gazeve, është i detyruar të organizojë shërbim për emergjenca dhe shpëtim.

4.1.3 Shërbimi për emergjenca dhe shpëtim organizohet i veçantë dhe nga çdo subjekt që zhvillon punime minerare nëntokësore dhe që në një turn punojnë më shumë se 50 punëtorë.

4.1.4 Të gjitha subjektet që zhvillojnë punime minerare nëntokësore në miniera dhe veprat energjetike, që kanë në punë në nëntokë deri në 50 punonjës në një turn dhe që nuk kanë mundësi të organizojnë vetë shërbimin e emergjencës dhe shpëtimit, janë të detyruar të sigurojnë dhe garantojnë për të gjithë kohën e zhvillimit të veprimtarisë këtë shërbim, duke kontraktuar me marrëveshje me palë të treta dhe që e kanë të miratuar këtë shërbim në AKSEM.

4.1.5 Shërbim për emergjenca dhe shpëtim në zhvillimin e punimeve minerare nëntokësore në miniera dhe veprat hidroenergjetike, mund të organizojë dhe çdo subjekt juridik e fizik, vendas a i huaj, që plotëson kushtet dhe kriteret për funksionimin e tij dhe që është i miratuar në AKSEM.

4.1.6 Njësi organizative të shërbimit për emergjenca dhe shpëtim janë skuadrat e emergjencës dhe shpëtimit që përbëhen nga 5–7 veta, shpëtues të punësuar ose vullnetarë.

4.1.7 Veprimtaritë për zhvillimin e punimeve me regjim gazi dhe që nëntokë në një turn kanë deri 50 veta, janë të detyruar të organizojnë këtë shërbim me 1 skuadër vullnetare, me kusht që përgjegjësi i skuadrës të jetë i punësuar i përhershëm.

4.1.8 Veprimtaritë për zhvillimin e punimeve nëntokësore me regjim gazi dhe që nëntokë në një turn kanë 50 deri 200 veta, janë të detyruar të organizojnë 1 skuadër shpëtimi me kohë të plotë punësimi.

4.1.9 Veprimtaritë për zhvillimin e punimeve nëntokësore me regjim gazi dhe që nëntokë në një turn kanë mbi 200 veta janë të detyruara të organizojnë këtë shërbim me dy

skuadra shpëtimi, një të punësuar të përhershëm dhe një skuadër vullnetare. Përgjegjësi i skuadrës vullnetare duhet të jetë i punësuar me kontratë pune pa afat.

4.1.10 Veprimtaritë e tjera që zhvillojnë punime nëntokësore në miniera dhe në veprat energjetike, që kanë të punësuar në nëntokë në një turn deri 100 veta, organizojnë këtë shërbim me një skuadër vullnetare për emergjenca dhe shpëtim, me kusht që përgjegjësi i skuadrës të jetë i punësuar me kontratë pune pa afat.

4.1.11 Veprimtaritë që kanë të punësuar në nëntokë 100 deri 250 veta, organizojnë këtë shërbim me skuadër për emergjencë dhe shpëtim të punësuar me kontratë pune pa afat (Aktive).

4.1.12 Veprimtaritë që kanë të punësuar nëntokë në një turn mbi 250 veta e organizojnë këtë shërbim me dy skuadra shpëtimi, një të punësuar dhe një vullnetar, me kusht që përgjegjësi i skuadrës vullnetare të jetë i punësuar me kontrate pune pa afat.

4.1.13 Të gjitha subjektet e tjera, vendase ose të huaja, që ofrojnë shërbim për shpëtim në veprimtaritë që zhvillojnë punime nëntokësore e të miratuara nga AKSEM-ja duhet të kenë skuadër shpëtimi të punësuar me kohë të plotë.

4.1.14 Për organizimin e shërbimit për emergjenca dhe shpëtim përgjigjet drejtuesi teknik i subjektit.

4.1.15 Subjektet që kryejnë aktivitet minerar mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me njëri-tjetrin për emergjencë dhe shpëtim në miniera, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

4.2 Funksionimi i shërbimit për emergjenca dhe shpëtim

4.2.1 Shërbimi për emergjenca dhe shpëtim në një subjekt që zhvillon punime minerare në nëntokë, në miniera dhe në veprat hidroenergjetike, është një shërbim funksional i vendosur nën autoritetin e drejtpërdrejt të drejtimit administrativ e teknik.

4.2.2 Për parandalimin dhe përballimin e emergjencës, largimin dhe shpëtimin e punonjësve, likuidimin e avarive të mundshme në proceset teknologjike, objektet nëntokësore, makineri, pajisje, subjektet janë të detyruara të sigurojnë dhe të garantojnë funksionimin e pandërprerë të këtij shërbimi dhe të skuadrës/skuadrave së shpëtimit, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të punimeve.

4.2.3 Zotëruesi i lejes minerare ose i lejes koncesionare, që zhvillon punime në nëntokë në minierë apo në vepra hidroenergjetike, siguron vendqëndrimin e përhershëm të skuadrës/skuadrave të shpëtimit dhe personave të tjerë që do të angazhohen në raste emergjence dhe shpëtimi. Këto vendqëndrime ndërtohen në sipërfaqe të veprës, në afërsi të hyrjes kryesore dhe përgjegjësi i skuadrës/skuadrave të shpëtimit përgjigjet për administrimin dhe mirëmbajtjen.

4.2.4 Kërkesat kryesore për vendqëndrimin e përhershëm të skuadrës/skuadrave për emergjencë dhe shpëtim janë, si më poshtë vijon:

a) të mbrojë personelin e emergjencave dhe shpëtimit nga faktorët atmosferikë, të ketë madhësi të mjaftueshme për qëndrimin e personave të angazhuar në operacionet e shpëtimit;

b) të garantojë hyrjen e automjetit, të gatishmërisë dhe ndihmën e shpejtë;

c) të ketë furnizim të garantuar me energji elektrike, ndriçim e ngrohje të mjaftueshme;

ç) të ketë sistem komunikimi, telefonin të garantuar me sipërfaqen, nëntokën dhe rrjetin kombëtar;

d) të ketë mjedise për kompletin e gatishmërisë, për aparaturat e frymëmarrjes, që janë të gatshme për përdorim dhe ato në riparim si dhe komplete të tjera të domosdoshme që nevojiten për operacion shpëtimi;

dh) të ketë mjedis për trajnime, instruktime dhe shërbime sociale e sanitare;

e) të ketë mjedis të mjaftueshëm për dhënien e ndihmës së parë dhe shërbimet mjekësore;

ë) të ketë mjedis të mjaftueshëm dhe të garantojë punë funksionale për skuadrat e emergjencës dhe të shpëtimit që vijnë në ndihmë nga subjekte të tjera apo AKSEM-ja.

4.2.5 Skuadrat për emergjencë dhe shpëtim, aktive (të punësuara) ose vullnetare, duhet të jenë të furnizuara dhe të kompletuara me të gjitha materialet, mjetet dhe pajisjet e nevojshme shpëtuese që sigurojnë dhe garantojnë parandalimin apo përballimin e çdo emergjence të

parashikuar në PESH, ndërhyrjet shpëtuese për raste konkrete dhe likuidim të avarisë e kthimin e gjendjes normale të punës.

4.2.6 Çdo subjekt që ka të organizuar shërbimin për emergjencë dhe shpëtim për funksionimin e tij është i detyruar të sigurojë e të garantojë vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të lajmërimit e të komunikimit të domosdoshëm midis nëntokës, sipërfaqes brenda subjektit dhe me rrjetin lokal e kombëtar. Në çdo vendqëndrim të përhershëm për ketë qëllim përgatitet instruksioni i veçantë, miratohet nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit dhe afishohet në vend të dukshëm.

4.2.7 Për çdo rast emergjence të parashikuar apo të lindur pa parashikim, drejtuesi teknik i subjektit si përgjegjës për emergjencë dhe shpëtim, garanton në nëntokë vende të sigurta shpëtimi (hapësira në punimet nëntokësore) për strehim të punonjësve të nëntokës kur ata për arsye të faktorëve të emergjencës nuk kanë mundësi të dalin të sigurt në sipërfaqe. Për çdo rast të emergjencave të parashikuara në PESH, në këto vendshpëtime duhet të vendosen pajisje vetëshpëtuese e komunikuese, lajmëruese e sinjalizuese për lidhje vendshpëtim-sipërfaqe. Këto vendshpëtime kontrollohen e mirëmbahen si çdo vend tjetër pune nga personeli teknik që drejton punën në objekt.

4.2.8 Për çdo rast emergjent të parashikuar apo të lindur pa parashikim, drejtuesi teknik i subjektit, si përgjegjës për emergjencën dhe shpëtimin, garanton në nëntokë vend të sigurt dhe sa më afër emergjencës ku qëndron dhe niset skuadra e shpëtimit në operacion shpëtimi. Ky vendqëndrim e vendnisje duhet të sigurojë e plotësojë kushte për qëndrim dhe për skuadrat e shpëtimit të subjekteve mbështetëse dhe të AKSEM-së. Për çdo rast emergjent të parashikuar në PESH apo të lindur pa parashikim në këto vendqëndrime e vendnisje sigurohen e vendosen pajisje komunikimi, lajmërimi e sinjalizimi për lidhje vendnisjeje në sipërfaqe. Këto vendqëndrime e vendnisje kontrollohen e mirëmbahen, si çdo vend tjetër pune, nga personeli teknik që drejton punën në objekt.

4.2.9 Zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare, që kryen veprimtari për zhvillimin e punimeve minerare nëntokësore, siguron dhe garanton bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e skuadrës/ave të tij për emergjencë e shpëtim me skuadrat e shpëtimit të subjekteve fqinje dhe skuadrat e shpëtimit të Drejtorisë së Emergjencave dhe Shpëtimit në AKSEM.

4.2.10 Në çdo rast, kur personeli administrativo-teknik i subjektit konstaton lindje apo zhvillim të një emergjence apo ndodhet para një avarie të mundshme dhe nuk merr dot vetë masa për eliminimin apo likuidimin të pasojave të saj, është i detyruar të njoftojë, menjëherë, Drejtorinë e Emergjencave dhe Shpëtimit në AKSEM.

4.3 Detyra për vetëshpëtim dhe ndihmën e shpejtë

4.3.1 Çdo subjekt që zhvillon punime në nëntokë në miniera dhe në vepra hidroenergjetike është i detyruar të pajisë të gjithë punonjësit e nëntokës me pajisje mbrojtëse e vetëshpëtimi personale.

4.3.2 Në pajisjet mbrojtëse personale përfshihen rrobat (veshjet), kapele, mushama, çizme, llamba individuale ndriçimi, dorashka, syze, kufje, rripa mbrojtës, maska kundër pluhurit, maska vetëshpëtuese etj.

4.3.3 Në vlerësim të rrezikshmërisë së gazeve, llojit apo tipit të emergjencës së parashikuar në PESH, maskat vetëshpëtuese mund të jenë pjesë e kompletit personal të punonjësit ose të jenë të grumbulluara në vende të caktuara në nëntokë në sasi të tilla që të sigurojnë për përdorim numrin më të madh të punonjësve në një ndërresë (turn).

4.3.4 Maskat vetëshpëtuese, kur përdoren në vende të caktuara në nëntokë, duhet të jenë në dollapë ose kaseta të sigurta, në mënyrë që të jenë të mbrojtura nga dëmtimet.

4.3.5 Vendet në nëntokë, ku vendosen ose ruhen maskat vetëshpëtuese, duhet të kenë shenjë të veçantë, të dallueshme dhe të dihet nga të gjithë punonjësit e nëntokës. Kontrolli i gjendjes së maskave vetëshpëtuese bëhet çdo muaj me komision të drejtuar nga drejtuesi teknik dhe rezultatet e kontrollit dokumentohen.

4.3.6 Çdo 6 muaj bëhet kontrolli i njohjes së rregullave të përdorimit të maskave vetëshpëtuese nga punonjësit dhe ky kontroll dokumentohet.

4.3.7 Personeli drejtues teknik i punëve në nëntokë kërkon nga çdo punonjës të veshë dhe të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale.

4.3.8 Çdo subjekt që ushtron punë në nëntokë, në minierë dhe në vepra hidroenergjetike, është i detyruar të sigurojë dhe të garantojë, në sipërfaqe të objektit dhe në çdo nivel kryesor në nëntokë, kasetat e ndihmës së shpejtë të pajisura me medikamente të nevojshme dhe për lidhje të plagës.

4.3.9 Këto kaseta mund të vendosen në vende të caktuara ose të mbahen me vete nga përgjegjësi i turnit apo brigadës.

4.3.10 Në sipërfaqe të objektit dhe afër punimeve nëntokësore përcaktohet vendi i ndihmës së parë e të shpejtë mjekësore. Punonjësit e nëntokës duhet të mësohen e të trajnohen për dhënien e ndihmës së parë mjekësore.

4.3.11 Për transportin e punonjësve të lënduar ose që janë sëmurë pa pritur gjatë punës, nga ambienti për në institucionin mjekësor më të afërt, subjekti siguron dhe garanton një automjet gatishmërie.

4.3.12 Dhoma e ndihmës së shpejtë duhet të përmbajë:

a) një barelë dhe të paktën 2 (dy) batanije të pastra.

b) një kuti të ndihmës së parë, që përmban fashë sterile të vogla, të mesme dhe të mëdha, lesh pambuku, shishe antiseptike, gërshërë të vogla dhe medikamente të tjera të ndihmës së parë.

V. VEPRIMTARIA PËR EMERGJENCË DHE SHPËTIM

5.1 Personeli i drejtimit të emergjencës dhe shpëtimit

5.1.1 Veprimtaria për emergjencë dhe shpëtim, për një rast emergjent në një subjekt që zhvillon punime minerare nëntokësore në minierë dhe në veprat hidroenergjetike, drejtohet nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit që është dhe drejtues i shtabit të emergjencës dhe shpëtimit dhe personeli tekniko-organizativ.

5.1.2 Zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare është i detyruar që sapo të marrë njoftimin për rastin emergjent të paraqitet menjëherë në objekt, të kontaktojë me përgjegjësin për emergjenca dhe shpëtim për t'u njohur me situatën e krijuar, të marrë masa dhe të kryejë veprime në zbatim të PESH-së dhe me personelin tjetër të drejtimit të sigurojë material, mjete, pajisje, burime njerëzore e financiare, mjedise e gjithçka tjetër që duhet dhe kërkohet për të përballuar emergjencën, shpëtimin e njerëzve, likuidimin e avarisë e vendosjen e gjendjes normale.

5.1.3 Zotëruesi i lejes minerare apo lejes koncesionare për vlerësimin apo përballimin e rastit emergjent hyn menjëherë në komunikim dhe, së pari, për çdo rast, njofton AKSEM-në, mban kontakte me strukturat shtetërore të emergjencës, lokale e kombëtare, me subjektet fqinje, me pushtetin qendror e vendor.

5.1.4 Në përfundim të emergjencës dhe të normalizimit të gjendjes, zotëruesi i lejes minerare apo lejes koncesionare bën analizën për shkaqet e ndodhjes së emergjencës, pasojat e saj, përcakton përgjegjësitë dhe masat e marra dhe raporton për to në AKSEM.

5.1.5 Përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit, me të marrë njoftimin paraqitet menjëherë në objekt dhe është përgjegjësi i vetëm teknik që zbaton PESH-në. Përgjegjësi i emergjencës komandon operacionin për largimin dhe shpëtimin e njerëzve, të likuidimit të pasojave të emergjencës dhe normalizimin e gjendjes në nëntokë.

5.1.6 Përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim mban kontakt të vazhdueshëm, sipas situatës, me zotëruesin e lejes minerare apo lejes koncesionare, konsultohet me shtabin e emergjencës dhe shpëtimit të subjektit, personelin teknik të subjekteve fqinje dhe drejtuesit për emergjencë e shpëtim të AKSEM-it.

5.1.7 Përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim përgatit raportin teknik përfundimtar të lindjes, zhvillimit, likuidimit të pasojave të rastit emergjent e të normalizimit të gjendjes për subjektin dhe AKSEM-në.

5.1.8 Nga zotëruesi i lejes minerare, lejes koncesionare dhe përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit njoftohet dhe sigurohet paraqitja në objekt e personelit tekniko-administrativ siç janë, specialistët e shërbimeve të tjera tekniko-administrative për minierë, gjeologji, hidrogjeologji, markshajderi, energomekanik, të ajrimit, shërbimet mbështetëse ekonomiko-financiare, transportit etj.

5.1.9 Çdo punonjës që bën pjesë në personelin tekniko-administrativ të subjektit, menjëherë sa merr njoftim për një rast emergjent, vepron me shpejtësi e profesionalizëm për zbatimin e detyrave të marra, sipas situatës së emergjencës dhe nuk largohet nga objekti pa lejen e përgjegjësit për emergjencë dhe shpëtim, deri në përfundim të emergjencës.

5.2 Personeli për shpëtim (shpëtues)

5.2.1 Personeli për shpëtim është i organizuar në skuadrat e emergjencës dhe shpëtimit. Personeli për shpëtim ka jo më pak se 5 veta, rekomandohet 7 veta, dhe përbëhet nga përgjegjësi i skuadrës, shpëtuesit, tekniku i aparaturave të frymëmarrjes.

5.2.2 Përgjegjësi i skuadrës për emergjencë dhe shpëtim, për çdo rast kur skuadra për emergjencë dhe shpëtim është e punësuar (aktive) dhe kur është vullnetare, është i punësuar i përhershëm dhe nuk angazhohet në kryerjen e detyrave të tjera. Ai caktohet nga zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare pas konsultimit me përgjegjësin për emergjencë dhe shpëtim pasi të ketë qenë shpëtues me eksperiencë pune pa ndërprerje për jo më pak se dy vjet dhe me moshë mbi 21 vjeç.

5.2.3 Shpëtuesi caktohet nga zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare pas konsultimit me përgjegjësin e emergjencës dhe shpëtimit. Ai duhet të pranojë me dëshirë që të punojë si shpëtues, mundësisht të zotërojë sa më shumë profesione ku përparësi të ketë profesioni i minatorit, armatorit, trolistit, shinashtruesit dhe të ketë punuar në nëntokë jo më pak se dy vjet, mundësisht me arsim të mesëm, të banojë afër objektit dhe të ketë moshën 21 deri 35 vjeç.

5.2.3 Personeli i skuadrës së shpëtimit, para se të caktohet për të punuar në veprimtari shpëtuese dhe në mënyrë periodike jo më rrallë se një herë në vit, duhet të kalojë në kontroll dhe mbikëqyrje mjekësore në lidhje me:

a) çrregullime të aparatit respirator;

b) çrregullime të aparatit kardio-vaskular, të tilla si: presioni i gjakut i përsëritur i kontrolluar apo i pakontrolluar nga ilaçet kur leximi tejkalon 160 sistolik dhe 100 distolik ose është më pak se 105 sistolik dhe 60 distolik të sëmundjeve të zemrës;

c) çrregullime muskulo-skeletore, të tilla si: mungesa e gjymtyrëve të poshtme apo të lartme (këmbët apo duart);

ç) çrregullime të aparatit urinar;

d) çrregullime të sistemit nervor;

dh) çrregullime të aparatit të dëgjimit, të tilla si: daullja e veshit të çarë dhe humbja e dëgjimit më e madhe se 40 hz, në frekuencë 100 hz, 400 hz, 2000 hz;

e) çrregullime të aparatit të shikimit;

ë) hernie diskale;

f) si dhe çdo rast tjetër që mjeku e shikon të arsyeshëm për ekzaminim të mëtejshëm.

5.2.4 Tekniku i aparaturave të frymëmarrjes caktohet nga zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare, pas konsultimit me përgjegjësin për emergjencë dhe shpëtim, pasi pranon me dëshirë për të punuar si teknik i aparaturave të frymëmarrjes, ka arsim të mesëm profesional elektromekanik.

5.2.5 Në përbërje të skuadrës për emergjence dhe shpëtim dhe në shërbim të gjithë punonjësve të subjektit, zotëruesi i lejes minerare apo koncesionare është i detyruar të sigurojë një mjek i cili mund të jetë i punësuar ose mund të shërbejë nëpërmjet një marrëdhënie kontraktuale.

5.2.6 Çdo person që caktohet të punojë për herë të parë në shërbimin për veprimtari emergjence e shpëtimi dhe në mënyrë periodike çdo 5 vjet, personeli që punon në këtë shërbim është i detyruar të kalojë për trajnim e testim pranë komisionit teknik të ngritur në Drejtorinë e

Emergjencave dhe Shpëtimit në AKSEM dhe të jetë i pajisur me certifikatë të dhënies së ndihmës së parë nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

5.2.7 Personeli i skuadrave për emergjencë dhe shpëtim trajnohet dhe testohet rregullisht, çdo vit, nga përgjegjësi i emergjencës dhe shpëtimit të subjektit. Ky personel, në situatë normale çdo dy muaj, në bashkëpunim me drejtuesit e tjerë të shërbimeve teknike të nëntokës, në përputhje me PESH azhurnohet me punimet nëntokësore që kryhen, njihet me problematikat e këtij zhvillimi dhe kryen veprimtari improvizuese shpëtuese me aparaturat respiratore dhe pajisjet e shpëtimit.

5.2.8 Në rastin e minierave afër ose ngjitur, nën drejtimin e përgjegjësit/ave të subjekteve për emergjence dhe shpëtim, skuadrat e çdo subjekti shkëmbejnë përvojë pune dhe kryejnë së bashku veprimtari praktike.

5.2.9 Personeli i skuadrës/ave të emergjencës dhe shpëtimit, në mënyrë të detyrueshme përvetëson PESH-në, të miratuar për objektin dhe azhurnohet më të sa herë PESH-ja ndryshon apo përmirësohet.

5.2.10 Praktikat improvizuese dhe trajnimi i personelit për emergjencë dhe shpëtim duhet të përfshijnë dhe programojnë lëvizje nëpër punimet më të vështira nëntokësore, improvizime të transportit me barelë të të lënduarve në punime, zbulime të të aksidentuarit dhe dhënie të shpejtë të ndihmës së parë, përdorim të pajisjeve dhe mjeteve të komunikimit, përdorim të aparaturave të matjes së gazeve, temperaturës së nëntokës, përdorim të kompleteve për shuarje zjarri, degazim të një fronti pune apo punim nëntokësor, zbërthim të planimetrisë së punës që ka PESH-ja, ndërtim armaturash në punime, realizim të kalimeve në punime të bllokuara, kalime me respirator në punime të ngushta, manovrim me maskë vetëshpëtuese e respirator, ndihma për anëtarin e skuadrës që ka defekt të respiratorit etj. Ky trajnim dhe çdo praktikë tjetër bëhet e programuar dhe nën drejtimin e përgjegjësit të skuadrës, e miratuar nga përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim të subjektit dhe dokumentohet në libër të veçantë.

5.3 Aparatet, pajisjet e mjetet e skuadrës për emergjencë dhe shpëtim

5.3.1 Personeli i skuadrës së emergjencës dhe shpëtimit është e detyrueshme të pajiset me mjetet apo aparaturat mbrojtëse të organeve të frymëmarrjes, ku më të domosdoshme janë: maskat vetëshpëtuese, aparati vetëshpëtues me oksigjen, aparati respirator e filtra rezervë për to, aparat për frymëmarrje artificiale (aparat të rigjallërimit), si dhe të gjitha pajisjet për kontrollin dhe kolaudimin e tyre.

5.3.2 Skuadra e emergjencës dhe shpëtimit është e detyrueshme të ketë për përdorim aparate apo pajisje për matjen dhe sinjalizimin e përqindjes së përbërjes së gazeve në atmosferën e punimeve nëntokësore apo vendndodhjen e emergjencës sidomos për gazet: CO, SO_2, H_2S, CO_2, H_2, CH_4, NOX.

5.3.3 Skuadra e emergjencës dhe shpëtimit është e detyrueshme të ketë për përdorim për çdo shpëtues pajisje të sigurta për ndriçim individual, rroba pune për përdorim të përhershëm, rroba pune të veçanta për ndërhyrje shpëtuese nga natyra e emergjencës së parashikuar në PESH, pajisje mbrojtëse për kokën, duart, këmbët, të sigurta për çdo operacion shpëtimi.

5.3.4 Në magazinat e subjektit ose në mjedise pranë vendqëndrimit të skuadrës së shpëtimit dhe sa më afër hyrjes për në punimet nëntokësore është e detyrueshme të jetë e gatshme për përdorim e gjithë baza materiale teknike e domosdoshme e planifikuar në PESH, për çdo rast emergjent. Kjo bazë materiale nuk përdoret për nevoja të përditshme dhe rifreskohet me afate të përcaktuara vetëm me urdhër të përgjegjësit për emergjencë dhe shpëtim.

5.4 Tekniku i pajisjeve dhe aparaturat e frymëmarrjes

5.4.1 Tekniku i aparaturave të frymëmarrjes është pjesë e rëndësishme e skuadrës për emergjencë dhe shpëtim. Ai është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen, funksionimin, gatishmërinë, kontrollin dhe kolaudimin e aparaturave e pajisjeve që disponon e përdor skuadra, ku më kryesoret janë, si më poshtë vijon:

a) grupimi i aparaturave dhe i pajisjeve sipas tipit, llojit, markës e standardit;

b) pajisja e tyre me shenja dalluese identifikuese për çdo shpëtues e person tjetër që thirret në emergjencë dhe veprimtari shpëtuese;

c) kontrollon dhe mban në provë, në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në muaj, aparaturat dhe pajisjet e shpëtimit, si dhe pjesët e ndërrimit dhe rezervë të tyre;

ç) kujdes të veçantë duhet të ketë për kontrollin dhe vlerësimin e afateve të skadencës (përdorimit) për çdo aparat, pajisje, pjesë ndërrimi të përcaktuara nga prodhuesi dhe marrja e masave të menjëhershme për zëvendësimin e tyre;

d) të heqë menjëherë nga përdorimi aparatet dhe pajisjet që nuk janë të rregullta, të bëjë riparimin e tyre, të njoftojë përgjegjësin e emergjencës dhe të shpëtimit për aparaturat që nuk riparohen;

dh) hap dhe mban kartelë për çdo aparaturë dhe pajisje dhe duhet ta plotësojë atë me të dhënat, si më poshtë vijon:

i. emri, mbiemri i tij dhe nënshkrimi;

ii. numri i kartelës;

iii. emërtimi i pajisjes dhe i aparaturës;

iv. të gjitha shërbimet që i bëhen nga vetë tekniku apo laboratori i institucionit tjetër të certifikuar;

v. kontrollet periodike që i bëhen çdo aparaturë apo pajisjeje;

vi. kontrollet para veprimtarisë shpëtuese apo trajnuese;

vii. kontrollet pas veprimtarisë shpëtuese apo trajnuese;

viii. datën e heqjes së përkohshme dhe kur kthehen në përdorim e gatishmëri;

ix. datën e heqjes përfundimtare nga përdorimi të aparaturës apo të pajisjes;

e) kartela paraqitet çdo muaj e plotësuar te përgjegjësi i skuadrës së shpëtimit dhe përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim dhe të dy nënshkruajnë në kolonën përkatëse;

ë) tekniku i aparaturave dhe i pajisjeve mban kartelë e regjistër dhe për çdo pajisje që përdor personeli teknik i subjektit për matjen dhe sinjalizimin e përqindjeve në përmbajtjen e gazeve në atmosferën e punimeve nëntokësore. Ai përgjigjet për afatet e përdorimit, kontrollin dhe kolaudimin e tyre.

f) zgjedhja dhe kompletimi i skuadrës për emergjencë dhe shpëtim me pajisje dhe aparatura të frymëmarrjes bëhet në funksion të tipit dhe të llojit të emergjencave të parashikuara në PESH dhe të rezultateve të vlerësimit të rrezikut. Rekomandohet që pajisjet dhe aparaturat e frymëmarrjes të jenë të një tipi dhe të të njëjtit prodhues, duke vlerësuar kohën e shërbimit të aparaturës në funksion të natyrës dhe të vështirësisë për kryerjen e punimeve nëntokësore.

VI. MBIKËQYRJA NGA AKSEM-ja DHE BASHKËVEPRIMI NË SUBJEKTE DHE PROVAT PËR TESTIMIN E GATISHMËRISË

6.1 Mbikëqyrja nga AKSEM-ja dhe bashkëveprimi në subjekte:

6.1.1 AKSEM-ja, si institucion i organizuar për emergjence dhe shpëtim, mbikëqyr dhe vlerëson në mënyrë periodike, por jo pak se një herë në vit, organizimin dhe funksionimin e skuadrës/ave për emergjencë dhe shpëtim, në subjekte që zhvillojnë punime nëntokësore në miniera dhe në vepra hidroenergjetike, si dhe sigurimin e garantimin e këtij shërbimi nga këto subjekte, por që këtë shërbim e kryejnë me marrëdhënie kontraktuale.

6.1.2 AKSEM-ja jep ndihmë të menjëhershme, të kualifikuar e të specializuar dhe hyn në bashkëveprim me skuadrat e subjektit për çdo rast emergjence dhe shpëtimi, sa herë që i kërkohet prej tyre dhe urdhrohet nga ministria që mbulon veprimtarinë minerare.

6.1.3 AKSEM-ja realizon e jep konsulencë, përgatit instruksione, trajnon personelin e emergjencave dhe shpëtimit, teston personelin e skuadrës së emergjencës dhe shpëtimit në çdo rast që kërkohet nga subjektet në zbatim të kësaj rregulloreje dhe funksionimin e sigurt të shërbimit për emergjencë dhe shpëtim në subjekte.

6.1.4 AKSEM-ja kontrollon dhe vlerëson funksionimin e PESH-së në subjekte, azhurnimin e tij me gjendjen aktuale të zhvillimit të punimeve nëntokësore dhe formimin e punonjësve me zbatimin e tij.

6.1.5 AKSEM-ja kontrollon funksionimin, mirëmbajtjen, shërbimin dhe kolaudimin e aparateve dhe të pajisjeve të frymëmarrjes e të testimit të gazeve të atmosferës në nëntokë.

6.1.6 AKSEM-ja kontrollon dhe vlerëson gjendjen e bazës materiale teknike të planifikuar në PESH, për përdorim nga subjekti vetëm në raste emergjence dhe shpëtimi.

6.1.7 AKSEM-ja programon dhe kryen stërvitje periodike të përbashkëta, të paktën 1 (një) herë në vit, në situatë të improvizuar emergjence e shpëtimi të subjektit/eve në kushte reale të zhvillimit të punimeve nëntokësore.

6.1.8 AKSEM-ja, kur konstaton shkelje të rregullave të përcaktuara në këtë rregullore, në funksion të zhvillimit të punimeve nëntokësore, vendos dënim administrativ kryesor e plotësues për subjektin.

6.1.9 AKSEM-ja dhe subjektet sigurojnë funksionimin e komunikimit të vazhdueshëm, gjatë gjithë kohës që subjekti zhvillon veprimtari nëntokësore. Subjektet njoftojnë menjëherë AKSEM-në për ndryshimet që mund të ndodhin në sistemin e komunikimit.

6.1.10 Subjektet njoftojnë Drejtorinë e Emergjencave dhe Shpëtimit në AKSEM në çdo kohë që ndërpresin, rifillojnë dhe përfundojnë veprimtarinë e zhvillimit të punimeve nëntokësore.

6.1.11 AKSEM-ja mban regjistër për subjektet që kanë të organizuar e funksional shërbimin për emergjencë dhe shpëtim, për subjektet që kanë kontraktuar këtë shërbim dhe për personelin e shpëtimit që kanë testuar e pajisur me dëshmi në AKSEM.

6.1.12 Subjekti që zhvillon punime nëntokësore njofton menjëherë në AKSEM, në çdo rast kur një anëtar i personelit të shpëtimit në skuadër largohet përgjithmonë, largohet në një skuadër të një subjekti tjetër apo e kundërta merret nga personeli i shpëtimit të një skuadre të një subjekti tjetër.

6.1.13 Subjekti që ka të miratuar, organizuar e ka bërë funksionale skuadrën/at për emergjencë dhe shpëtim dhe për mungesë të burimeve njerëzore, materiale financiare i del jashtë funksionit apo shërbimi i kontraktuar për emergjence dhe shpëtim nuk i përgjigjet është i detyruar të ndërpresë veprimtarinë e zhvillimit të punimeve deri në organizimin e funksionimin e këtij shërbimi. Në këtë rast njoftohet menjëherë AKSEM-ja.

6.2 Provat për testimin e gatishmërisë

6.2.1 Personeli i drejtimit të shpëtimit dhe personeli i shpëtimit, nga koha që marrin njoftim për rast emergjence, duhet të paraqiten në objekt jo më vonë se 45 minuta.

6.2.2 Në mënyrë të programuar ose rastësore, zotëruesi i lejes minerare, zotëruesi i lejes koncesionare dhe përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim kryejnë prova për testimin e gjendjes së gatishmërisë dhe aftësisë vepruese të skuadrës/ave të emergjencës dhe shpëtimit. Ky veprim dokumentohet në libër të veçantë nga personi që urdhëron provën për testim.

6.2.3 Në rast se për dy prova rresht për testimin e gatishmërisë evidentohen raste nga personeli i shpëtimit që nuk paraqitet në kohë apo nuk paraqitet fare, merret masë për largimin e tij nga shërbimi për emergjencë dhe shpëtim dhe zëvendësimin e tij.

6.2.4 Përgjegjësi për emergjencë dhe shpëtim është i detyruar për komunikim të vazhdueshëm me personelin e shpëtimit për gjendjen e tyre shëndetësore, psiko-morale, dëshirën për të vazhduar punën në këtë shërbim dhe kur konstaton probleme merr masat e nevojshme për rikontroll e mbikëqyrje mjekësore apo zëvendësimin e tij.

6.2.5 Në funksion të veprimeve për zbatimin e pikave 2.3 dhe 2.4 dhe të masave të marra njoftohet Drejtoria e Emergjencave dhe Shpëtimit në AKSEM.